



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË E JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM ELBASAN

Nr. Regj. Them. (13000-00181-13-2024) 997

Nr. vendimit: 997

Data e regjistrimit: 31.01.2024

Data e vendimit: 05.02.2024

VENDIM I NDËRMJETËM
(Për sigurimin e padisë)

VENDIM I SHKURTUAR

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan e përbërë nga:

GJYQTAR: ARDIT KUKA

Asistuar nga sekretarja gjyqësore Znj. Alketa Çerekja, në Elbasan, sot më datë 05.02.2024 në seancë gjyqësore publike, mori në shqyrtim çështjen civile, që i përket:

PADITËS: Shoqëria tregtare "Alb Tech Plast" sh.p.k, me NUIS: L38725101G, përfaqësuar nga Av. Aldo Shkëmbi, me autorizim.

I PADITUR: Petro Pina, përfaqësuar nga Av. Alban Alimema dhe Av. Andi Skënderi, me deklaram në seancë.

OBJEKTI: Marrjen e masës së sigurimit të padisë, duke pezulluar të drejtën e votës së ortakut Petro Pina, si dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, derisa vendimi të marrë formë të prerë.

BAZA LIGJORE: Nenet 31, 41, 51, 153 të K.Pr. Civile. Nenet 13, 17, 18, 89, 102 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",

Gjykata e Shkallës së Parë e Juridiksionit të Përgjithshëm Elbasan, bazuar në nenet 202, 208, 310 të Kodit të Procedurës Civile, si dhe nenin 102/2 të Ligjit nr. 9901/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare",

VENDOSI:

- Pranimin e kërkesës për sigurimin e padisë.
- Pezullimin e votës së ortakut Petro Pina në shoqërinë tregtare "Alb Tech Plast" sh.p.k., si dhe të drejtat që rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, derisa vendimi të marrë formë të prerë, me kushtin e vendosjes së garancisë në shumën 20,000 (njëzet mijë) euro në favor të ortakut Petro Pina.
- Kundër këtij vendimi lejohet ankim i veçantë në Gjykatën e Apelit të Juridiksionit të Përgjithshëm, brenda 5 (pesë) ditëve nga e nesërmja e njoftimit të arsyetuar të tij.

U shpall në Elbasan, më 05.02.2024.

SEKRETARE

ALKETA ÇEREKJA



GJYQTAR

ARDIT KUKA